



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

B.Curri më: 18.01.2018

SHPLLJE

**PËR LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE PËR POZICIONIN**

Punonjëse sociale për mbrojtjen e fëmijeve dhe grave të dhunuara

Niveli minimal i diplomës “ Master profesional ”

Në shkenca Sociale

Kategoria e **IV-a**

- Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Tropojë, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

-Kërkohen **1 (një)** Punonjes social për mbrojtjen e fëmijeve dhe grave të dhunuara në Bashkinë Tropojë **kategoria VI-a.**

-Pozicioni i më sipërm, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.

-Vetëm në rast se këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë vakante, atëherë janë të vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive aplikohet në të njëjtën kohë

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: **29.01.2018**

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:**02.02.2018**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre.

2. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe grave të dhunuara ka për detyrë:

- a) të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës apo grave në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet vizitave periodike në terren dhe në familje. komunikimit me profesionistët nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit;
 - b) të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës apo grave në nevojë për mbrojtje;
 - c) të kërkojë mbledhjen e grupit teknik ndërsektorial dhe të hartojë Planin Individual të Mbrojtjes, pjesë e të cilit është edhe propozimi për marrjen e masave të mbrojtjes;
 - ç) të informojë Pergjegjsin e sek. Ndhmes shoqerore dhe t'i propozojë marrjen e masave të mbrojtjes Femijës në nevojë apo grave të dhunuara mbi bazën e Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe të kordinojë ndërhyrjet e veprimet që përcaktohen në plan;
 - d) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë ose grave të dhunuara me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të prokurorisë dhe të gjyqësorit, në nivel vendor e kombëtar, si dhe me shoqërinë civile, duke ruajtur të dhënat personale të fëmijës apo gruas dhunuar;
 - dh) të monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të masës së mbrojtjes, progresin e zhvillimit të fëmijës ne nevoj ose gruas dhunuar, për të cilin është vendosur masa e mbrojtjes. Profesionistët e tjerë, të përfshirë në zbatimin e masës së mbrojtjes apo të Planit Individual të Mbrojtjes, janë të detyruar ta mbajnë të informuar punonjësin e mbrojtjes së fëmijës apo gruas dhunuar në lidhje me progresin, sfidat dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të tyre;
 - e) të propozojë ndryshimin apo heqjen e masës së mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes nëse nuk ekzistojnë më kushtet, për shkak të të cilave është vendosur masa dhe plani, apo kur një gjë e tillë i shërben fëmijës apo gruas dhe/ose është në interesin më të lartë të tij apo sajë;
 - ë) të lehtësojë dhe të mbështesë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës ose gruan e dhunuar në përmbushjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes;
 - f) të marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në planet individuale të mbrojtjes së fëmijës ose gruas dhunuar, për të cilët është menaxher rasti;
 - g) t'i drejtohet prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e vënë atë në dijeni për prindërit që tregojnë pakujdesi të rëndë në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ose kur, me veprimet e tyre, prindërit ndikojnë në mënyrë të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.
 - gj) të ndihmojë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.
 - h-Përgjigjet para përgjegjësit sektorit të ndihmes shoqerore për menaxhimin e çështjeve që kanë të bëjnë me plotësimin, hartimin e dokumentacionit për fëmijet dhe grat e dhunuara kjo në zbatim të akteve ligjore e nenligjore apo aktet rregullore në fuqi .
- 3-Kryen punë specifike Brenda sektorit ndihmes shoqerore, brenda rregullave, ligjeve dhe udhëzimeve të përgjithshme lidhur me afatet përfundimtare të detyrave.
- 4-Realizon detyrat në përputhje me politikat e institucionit me standartet administrative dhe procedurat teknike, si dhe duke mbajtur parasysh praktikën më të mira profesionale.
- 5- Planifikon dhe përmbush detyrat e ngarkuara në mënyrë profesionale dhe të pavarur.
- 6-Identifikon mundësitë për përmirsimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave të

përdorura në permbushjen e detyrave.

7-Përgatit në kohë dhe me cilësi materialet dhe informon në kohe eproret për këto materiale

8-Zbaton Rekomandimet apo sugjerimet e eproreve me qëllim përmirsimin e praktikave apo procedurave, në fushën e mbrojtjes fëmijëve dhe grave të dhunuara.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

• **KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit **MASTER PROFESIONAL** ose të barsvlefshëme në Shkenca Sociale edhe Bachelori duhet të jetë përfunduar në punë sociale
- Të ketë eksperiencë pune të paktën 1 vit në profesion
- Të kenë njohuri baze për programet kompjuterike.

• **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë, dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopjet e diplomës masterit ose të barsvlefshme (përfshirë edhe diplomën bachelor) dhe listen e notave; Nëse studimet janë kryer jashtë shtetit së bashku me diplomën duhet të përcillet edhe njehsimi i diplomes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropoje, brenda datës **29.01.2018**

- **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **31.01.2018** njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë do të shpallë në stenden e informacionit Bashkisë të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e verifikimit paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e posaçme. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).Ndërsa me dt.**08.02.2018** shpallet lista e verifikuar e kandidateve qe kualifikohen në fazen e parë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë.

- **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 3-Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- 4-Kodi i Proçedurave Administrative;
- 4-Kodi i Etikes
- 6- Ligji nr.18/2017 “Për të drejten dhe mbrojtjen e femijëve”
- 7-Ligji nr.9669 dt.18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në mardhënjet familjare i ndryshuar
- 8-VKM nr 334 dt.17.02.2011”Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në mardhënjet familjare dhe mënyren e proçedimit tij .

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar . Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit Kandidatet do te njoftohet për rezultatet e arritura dhe fituesin, njoftimi do të shpallet në stenden e informacionit të Bashkisë Tropojë dhe në portalin

“Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ndërsa personat të cilët nuk kualifikohen njoftohen në mënyrë elektronike nëpërmes (e-mail) të kandidatëve.

2.-PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në stenden e informacionit të Bashkisë Tropojë duke filluar nga data **08.02.2018** e në vazhdim

2.1- KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formësë prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**
- Të zotërojnë diplomë të nivelit **MASTER PROFESIONAL** ose të barasvlefshëm në Shkenca Sociale, edhe Bachelori duhet të jetë përfunduar në punë sociale .
- Të ketë eksperiencë pune mbi 1 vit në profesion
- Të kenë njohuri bazë për programet kompjuterike.

2.2- DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://administrata.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor); Nëse studimet janë kryer jashtë vendit duhet që të përcillet njësimi I diplomes nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.

- Vetedeklarim që nuk është perjashtuar me masë disiplinore nga shërbimi civil
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, duhet të bëhen nëpërmes postës Shqipëtare ose dorazi pranë zyrës sekertari-arkivit Bashkise Tropojë .
Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës **02.02.2018**

2.3- REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.02.2018** Bashkia Tropoje do të shpallë në Stenden e informacionit Bashkise Tropoje dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e verifikimit paraprake të kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Tropoje, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail). Ndërsa me dt. **22.02.2018** shpallet lista e verifikuar e kandidateve që kualifikohen dhe mund të vazhdojnë konkurimin , po në këtë datë do të shpallet vendi, ora dhe data e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e ristrukturuar me gojë.

2.4- FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim dhe intervistohen me gojë

Kandidatët në testimin me shkrim do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; i ndryshuar
- 3-Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- 4-Kodin e Proçedurave Administrative;
- 5-Ligjin për kodin e etikës
- 6- Ligji nr.18/2017 “Për të drejten dhe mbrojtjen e femijeve”
- 7-Ligji nr.9669 dt.18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në mardhënjet familjare i ndryshuar
- 8-VKM nr 334 dt.17.02.2011”Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në mardhënjet familjare dhe mënyrën e proçedimit tij .

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 -MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin për testin me shkrim deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al” <http://administrata.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

-Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit ” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive: për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

-Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e Shërbimit kombëtar të punësimit” dhe Stenden e informacionit Publikut Bashkise Tropoje duke filluar nga data **12.02.2018**.e në vazhdim

-Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë të cilët nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) .

.- Në përfundim të konkurimit Bashkia Tropojë , do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”dhe në Stenden e informacionit publikut Bashkise .

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE